

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 18.11.2018]

Për: Operatorin Ekonomik “Company Riviera 2008” shpk, me adrese: rruga nacionale Kamez – Fushe Kruje, kthesa e Valiasit nr 1, zona kadastrale 2066, numri i pasurise 62/35, me NIPT K81716011V.

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksioni i Rrugës së Beratit (Plasmas – Karbunarë) Bashkia Lushnje”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i Rrugës së Beratit (Plasmas – Karbunarë) Bashkia Lushnje”.**

Numri i referencës së procedurës: **REF-84489-09-03-2018.**

Kohëzgjatja: brënda 6 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 122.273.551 (njëqind e njëzet e dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 24.454.710 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 10.10.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"RIVIERA" SHPK (60%)	J66903244D	64,432,830
	"GLAVENICA" SHPK (40%)	K17710805A	
2	"BIBA X" SHPK (80%)	K32618815N	68,472,957
	"LALA" SHPK (20%)	J76418903B	

3	"COMPANY RIVIERA 2008" SHPK	K81716011V	69,330,179
4	"SMO UNION" SHPK	J66902042Q	72,764,843
5	"B 93" SHPK	J62903508R	73,302,852
6	"SHKELQIMI 07" SHPK	K68121808W	78,000,007
7	"BAJRAMI N" SHPK	K02727202O	78,858,066
8	"MELA" SHPK (40%)	K62320011G	80,000,000
	"ALBSHPRESA" SHPK (60%)	J72110003F	
9	"T&T BETON" SHPK (70%)	K83103001E	81,556,661
	"VELLEZERIT HYSA" SHPK (30%)	K12911201C	
10	"BE-IS" SHPK	K71412003A	83,990,580
11	"SALILLARI" SHPK	J62903125G	85,557,245
12	"ZDRAVO" SHPK (60%)	J84003411K	90,231,067
	"VARAKU E" SHPK (40%)	J61902509S	
13	"RSM COMPANY" SHPK (81%)	L04803001U	90,263,344
	"XHAJ" SHPK (19%)	K12512837I	
14	"ERAL KONSTRUKSION" SHPK (40%)	K82230002K	90,313,083
	"STERKAJ" SHPK (60%)	J68310708M	
15	"GPG COMPANY" SHPK	J64324443V	90,627,915
16	"KUPA" SHPK (60%)	K51615512C	91,540,890
	"LIQENI VII" SHPK (40%)	K01730502W	
17	"SIRETA 2F" SHPK	K51501008J	97,777,777
18	"LLAZO" SHPK	K24218401K	NUK KA PARAQITUR FORMULAR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimit e Operatoreve Ekonomike “Riviera” shpk (60%) dhe “Glavenica” shpk (40%) pasi:

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi ne deklaraten e paraqitur shprehet se ka shlyer detyrimet deri ne daten 30 qershor 2018, nderkohe qe ne kerkesen per kualifikim eshte kerkuar deri ne daten 30 gusht 2018.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin minimal te te punesuarve pasi per te plotesuar kerkesen per kualifikim duhet te paraqiste dokumentacion per punesimin e nje numri minimal punonjesish prej 75 vetesh per muajt shkurt 2018 deri gusht 2018, nderkohe qe kjo shoqeri ka 41 persona per muajin maj, 40 persona per muajin qershor, 39 persona per muajin korrik dhe 38 persona per muajin gusht 2018, me pak se numri minimal i pranuar.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe

paisjeve, pasi ka paraqitur mjetin rrul bitelli combit me nr shasie 930102, marre me qera nga “Spartaku” shpk ne daten 14 shkurt 2018 me afat 2 vjecar, nderkohe qe te njejtin mjet e ka paraqitur ne tender edhe shoqeria “Glavenica” shpk e cila e ka marre me qera nga “Spartaku” shpk ne daten 15 prill 2016 me afat 5 vjecar.

Ka paraqitur mjetin rrul 20 ton HAMM3520HT, marre me qera nga Armand Gremi ne daten 15 shkurt 2018 me afat 2 vjecar, nderkohe qe te njejtin mjet e ka paraqitur ne tender edhe shoqeria “Zdravo” shpk e cila e ka marre me qera nga Armand Gremi ne daten 03 tetor 2018 me afat 2 vjecar.

Ka paraqitur mjetin autobitumatrice me targe AA230HV, marre me qera nga “A Klas Beton” shpk ne daten 20.10.2018 me afat 3 vjecar, nderkohe i njejtin mjet i eshte dhene me qera shoqerise “ED Konstruksion” shpk ne daten 23.10.2018 (perseri nga shoqeria “A Klas Beton” shpk) per objektin “Projekti zhvillimor i bllokut nr 2 Roskovec”.

Dokumentat e paraqitur per keto tre mjete jane fiktive, te paraqitur per qellim kualifikimi.

Shoqeria “Glavenica” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi ne deklaraten e paraqitur shprehet se ka shlyer detyrimet deri ne daten 30 qershor 2018, nderkohe qe ne kerkesen per kualifikim eshte kerkuar deri ne daten 30 gusht 2018.

Shoqeria “Glavenica” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi ka marre persiper punime shtresa binderi dhe asfaltobetoni dhe nuk ka asfaltoshtruese dhe fabrike asfalti. Po ashtu ka marre persiper te realizoje edhe shtresa betoni dhe nuk ka autobetoniere. Kjo shoqeri ka paraqitur mjetin rrul bitelli combit me nr shasie 930102, marre me qera nga “Spartaku” shpk ne daten 15 prill 2016 me afat 5 vjecar, nderkohe qe te njejtin mjet e ka paraqitur ne tender edhe shoqeria “Riviera” shpk e cila e ka marre me qera nga “Spartaku” shpk ne daten 14 shkurt 2018 me afat 2 vjecar.

Shoqeria “Glavenica” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.11 per kualifikim lidhur me disponimin e certifikatave ISO, pasi nuk ka paraqitur certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Biba X” shpk (80%) dhe “Lala” shpk (20%) pasi:

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi per vitin 2017 nuk ka paraqitur mandat pagesat per shlyerjen e detyrimeve ne Rrogozhine, Tirane dhe Skrapar ndersa per vitin 2018 nuk ka paraqitur mandat pagesat per shlyerjen e detyrimeve ne Perrenjas, Shijak, Pogradec dhe Tirane. Ne kerkesen per kualifikim eshte kerkuar shprehimisht qe Operatori Ekonomik te paraqese “...vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe, **shoqeruar me mandatet perkates te pagesave**”.

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur lidhur me numrin minimal te te punesuarve pasi, bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper (80%), per te plotesuar kerkesen per kualifikim duhet te paraqiste dokumentacion per punesimin e nje numri minimal punonjesish prej 60 vetesh per muajt shkurt 2018 deri gusht 2018, nderkohe qe kjo shoqeri ka 58 persona per muajin mars 2018, me pak se numri minimal i pranuar.

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me lidhur me deklarimin me

shkrim se punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.2 per kualifikim nuk jane te angazhuar ne kontratat qe operatori ekonomik ka aktualisht ne proces zbatimi, pasi punonjesit e saj jane te angazhuar ne objektet "Rikonstruksioni i rruges Fatmir Hazhiu", me bashkine Tirane, me vlere 25.563.746 leke pa tvsh (ku referuar DST jane angazhuar 25 punonjes), dhe "Rikonstruksion i trotuareve shetitorja nr. 2 Kavaje", me bashkine Kavaje, me vlere 69.668.590 leke pa tvsh, te cilat jane ne proces zbatimi. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se kjo shoqeri ka 64 punonjes per muajin shkurt 2018, 58 punonjes per muajin mars 2018, 68 punonjes per muajin prill 2018, 66 punonjes per muajin maj 2018, 64 punonjes per muajin qershor 2018, 62 punonjes per muajin korrik 2018 dhe 62 punonjes per muajin gusht 2018. Numri i punonjesve te pa angazhuar, referuar dokumentacionit te paraqitur, rezulton te jete jo me i madh se 43 punonjes nga 60 te kerkuar bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper (80%). Ky numer eshte llogaritur pa marre parasysh punonjesit e angazhuar ne kontraten "Rikonstruksion i trotuareve shetitorja nr. 2 Kavaje" per te cilet komisioni i vleresimit nuk disponon ende numrin e punonjesve te angazhuar. Ne kete menyre deklarata e leshuar nuk eshte e sakte dhe operatori ekonomik nuk disponon fuqi punetore te lire ne masen qe kerkohet ne kerkesen per kualifikim.

Shoqeria "Biba X" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me disponimin e inxhinierëve, pasi ka marre persiper punime shtresa betoni, struktura monolite betoni, ndertim puseta etj dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e nje inxhinieri ndertimi (ka paraqitur dokumentacion vetem per nje inxhinier ndertimi me profil transport, i cili eshte i specializuar dhe do te angazhohet me ndertimin e shtresave rrugore).

Shoqeria "Biba X" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon grejder dhe ka marre persiper punimet e shtresave per te cilat ky mjet eshte i domosdoshem. Gjithashtu nuk disponon autobot uji dhe ka marre persiper punime betoni etj. Keta dy mjete disponohen nga shoqeria "Lala" shpk (pjesetare e bashkimit te shoqerive), por ne marreveshjen e bashkepunimit nuk eshte rene dakord qe t'ja vere ne dispozicion shoqerise "Biba X" shpk pa shperblim dhe nuk ka kontrate qeraje mes tyre.

Shoqeria "Lala" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me disponimin e inxhinierëve, pasi ka marre persiper punime kanalizime ujra te bardha dhe nuk ka ing hidroteknik, i domosdoshem per kryerjen e ketyre punimeve.

3. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik "SMO Union" shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur mandat pagesat ne perputhje me kerkesen per kualifikim. Ne kerkesen per kualifikim eshte kerkuar shprehimisht qe Operatori Ekonomik te paraqese "...vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe, *shoqeruar me mandatet perkates te pagesave*".

Nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin minimal te te punesuarve pasi per te plotesuar kerkesen per kualifikim duhet te paraqiste dokumentacion per punesimin e nje numri minimal punonjesish prej 75 vetesh per muajt shkurt 2018 deri gusht 2018, nderkohe qe kjo shoqeri ka 70 persona per muajin gusht 2018, me pak se numri minimal i pranuar.

4. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik "B 93" shpk pasi:

Nuk ploteson kërkesen 2.3.2 për kualifikim lidhur me numrin minimal të të punësuarve pasi për të plotësuar kërkesen për kualifikim duhet të paraqiste dokumentacion për punësimin e një numri minimal punonjësish prej 75 vetësh për muajt shkurt 2018 deri gusht 2018, ndërkohë që kjo shoqëri ka 66 persona për muajin prill, 60 persona për muajin korrik dhe 52 persona për muajin gusht 2018, me pak se numri minimal i pranuar.

Duke qenë se kjo e mëte është thelbësore, komisioni vendosi të mos vazhdojë me me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqëri.

5. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Shkelqimi 07” shpk pasi:

Nuk ploteson kërkesen 2.3.4 dhe 2.3.5 për kualifikim lidhur me disponimin e inxhinierëve, pasi ing. ndertimi Elida Qyrana, ing. ndertimi me profil transport Saidjon Kodhelaj dhe ing. elektrik Vjollca Bidaj janë të deklaruar dhe të angazhuar në procedurën “Rikonstruksioni i rrugës Ramize Gjëbrea, faza 2 (lidhja e rrugës së pyllit të sodes me rrugën transballkanike dhe autostradën)”, në të cilën kjo shoqëri është shpallur fituese në datën 05.10.2018. Kontrata përkatëse është lidhur në datën 09.10.2018, përpara datës së hapjes së ofertave.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.8 dhe 2.3.9 për kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi mjetet e paraqitur në këtë procedurë janë të deklaruar dhe të angazhuar në procedurën “Rikonstruksioni i rrugës Ramize Gjëbrea, faza 2 (lidhja e rrugës së pyllit të sodes me rrugën transballkanike dhe autostradën)”, në të cilën kjo shoqëri është shpallur fituese në datën 05.10.2018. Kontrata përkatëse është lidhur në datën 09.10.2018, përpara datës së hapjes së ofertave.

Duke qenë se këto të meta janë thelbësore, komisioni vendosi të mos vazhdojë me me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqëri.

6. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “T&T Beton” shpk (70%) dhe “Vellezerit Hysa” shpk (30%) pasi:

Në marrëveshjen e bashkëpunimit nuk përcaktohen punët konkrete që do të kryejë secila shoqëri. Lista përkatëse është paraqitur vecmas, por nuk është deklaruar për noterit siç kërkon ligji.

Duke qenë se këto të meta janë thelbësore, komisioni vendosi të mos vazhdojë me me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqëri.

7. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Zdravo” shpk (60%) dhe “Varaku E” shpk (20%) pasi:

Shoqëria “Zdravo” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.8 për kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi ka paraqitur mjetin rrul 20 ton HAMM3520HT, marrë me qera nga Armand Gremi në datën 03 tetor 2018 me afat 2 vjeçar, ndërkohë që të njëjtin mjet e ka paraqitur në tender edhe shoqëria “Riviera” shpk e cila e ka marrë me qera nga Armand Gremi në datën 15 shkurt 2018 me afat 2 vjeçar. Dokumentat e paraqitur për këtë mjet janë fiktive, të paraqitur për qëllim kualifikimi.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

8. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “RSM Company” shpk (81%) dhe “Xhast” shpk (19%) pasi:

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin minimal te te punesuarve pasi per te plotesuar kerkesen per kualifikim (sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper) duhet te paraqiste dokumentacion per punesimin e nje numri minimal punonjesish prej 60 vetesh per muajt shkurt 2018 deri gusht 2018, nderkohe qe kjo shoqeri ka 55 persona per muajin shkurt (27 ne Kosove dhe 28 ne Shqiperi) dhe 54 persona per muajin mars (26 ne Kosove dhe 28 ne Shqiperi), me pak se numri minimal i pranuar.

Shoqeria “Xhast” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper duhet te kishte realizuar ne tre vitet e fundit nje pune te ngjashme me vlere 11.615.987 leke pa tvsh ($122.273.551 \text{ leke} \times 19\% \times 0,5 = 11.615.987 \text{ leke}$ pa tvsh) nderkohe qe me punen e deklaruar “Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges se fshatit Vlahen, komuna Golaj”, referuar faturave tatimore te paraqitura ne tender, ka realizuar ne tre vitet e fundit 4.829.850 leke punime, pasi pjesa tjeter eshte kryer perpara tre viteve te fundit.

Shoqeria “Xhast” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.11 per kualifikim lidhur me certifikatat ISO, pasi nuk ka paraqitur certifikatat e kerkuara.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

9. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Kupa” shpk (60%) dhe “Liqeni VII” shpk (40%) pasi:

Shoqeria “Kupa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin e inxhinierëve, pasi, referuar marreveshjes se bashkepunimit, ka marre persiper te kryeje punime rrugore dhe nuk disponon inxhinier ndertimi me profil transport, i domosdoshem per kryerjen e ketyre punimeve.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

10. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Sireta 2F” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin e inxhinierëve, pasi ing ndertimi me profil transport Florenc Grembi, ing hidroiteknik Marsela Lila, ing elektrik Leonidha Rebi dhe ing gjeodet Desantila Farka jane te angazhuar ne realizimin e kontrates "Unaza e re Peshkopi", lidhur me FSHZH, kontrate e cila eshte ne proces zbatimi. Ne kete menyre edhe deklarata e bere ne zbatim te kerkeses 2.3.4 per kualifikim rezulton e rreme.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi pjesa me e madhe e

mjeteve te dektuar ne kete procedure jane te angazhuar ne realizimin e kontrates "Unaza e re Peshkopi", lidhur me FSHZH, kontrate e cila eshte ne proces zbatimi. Ne kete menyre edhe deklarata e bere ne zbatim te kerkeses 2.3.9 per kualifikim rezulton e rreme.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

11. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik "Llazo" shpk pasi: Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **"Company Riviera 2008" shpk**, me adrese: rruga nacionale Kamez – Fushe Kruje, kthesa e Valiasit nr 1, zona kadastrale 2066, numri i pasurise 62/35, me NIPT K81716011V, se oferta e paraqitur, me vlerë **69,330,179 (gjashtedhjetë e nente milion e treqind e tridhjetë mijë e njëqind e shtatedhjetë e nente) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjor nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **01.11.2018**.

Per proceduren,ne daten 02.11.2018 paraqiti ankese shoqeria "Bajrami N" shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 05.11.2018 duke mos e pranuar ate. Ankime ne KPP nuk ka patur.

Benet BECI

Drejtori Ekzekutiv

Konceptoi: M. Juka